

Qëndrimi i profesionistëve të shëndetit mendor ndaj dëshirës së pacientëve për t'u martuar dhe për të pasur fëmijë

Dr. Shk. Pasho Maksuti, QSUT "N. Tereza"-Tiranë

Dëshira për të pasur fëmijë është një çështje e rëndësishme për të gjithë njerëzit në moshë të re dhe të mesme, pavarësisht nëse janë të sëmurë mendorë apo jo. Ndërgjegjësimi mbi çështjen e riprodhimit dhe prindërimit është rritur nga përdoruesit e shërbimeve të shëndetit mendor, ndërsa nga profesionistët e shëndetit mendorë kërkohet të vlerësojnë çështjen e të qenit prind gjatë punës së përditshme. Gjithësesi, çështja e riprodhimit duket se konfronton profesionistët e shëndetit mendor me sfidat etike.

Profesionistët e shëndetit mendor shpesh nuk e vlerësojnë aq të rëndësishme në praktikën e përditshme dëshirën e pacientëve për t'u martuar ose/dhe për të pasur fëmijë, krahasuar me çështjen e funksionit të prindit. Gjatë diskutimit mbi këto dëshira, shpesh shqyrtohen temat: "vendimi i pacientit", "neutraliteti", "mirëqenia e pacientit", "problemet që hasin fëmijët me prindër të sëmurë", "të qenit prind i mirë", "problemet e divorcit" dhe "problemet e potencës seksuale". Për t'u përballur me të kuptuarit e normës, profesionistët e shëndetit mendor kanë zhvilluar strategjitë që vijnë: "varësia e asistencës materiale për fëmijët", "deprofesionalizimi", "dhënia e këshillave racionale" dhe "heqja dorë".

Në lidhje me dëshirën e të sëmurëve mendorë për t'u martuar dhe për të pasur fëmijë, ndërmjet profesionistëve të shëndetit mendor dominon tema e "pavarësisë riprodhuese", e cila qëndron në konflikt temën tjetër, "fëmijët e pacientit". Duke e trajtuar si tabu problemin e riprodhimit, është krijuar hendeku ndërmjet perceptimit të PSHM lidhur me dëshirën e pacientëve për të pasur fëmijë dhe mundësisë së kufizuar për t'u përballur me ata në mënyrë të drejtë.

Fjalë kyçe: Martesa, fëmijë, etika, PSHM (profesionistë të shëndetit mendor).

Literatura:

- Brockington I, Chandra P, Dubowitz H, Jones D, Moussa S, Nakku J, Quadros Ferrre I: WPA guidance on the protection and promotion of mental health in children of persons with severe mental disorders. World Psychiatry. 2011, 10: 93-102.
- Slack K, Webber M: Do we care? Adult mental health professionals' attitudes towards supporting service users' children. Child Fam Soc Work. 2008, 13: 72-79.

Commented [U1]:

The attitude of mental health professionals to patients' desire to be married and to have children

The desire to have children is an important issue for all people of young and average age, whether or not they are suffered from mentally illnesses. Awareness on the issue of reproduction and parenting grew by users of mental health services, and mental health professionals are required to assess the issue of parenthood in their everyday work. However, the issue of reproduction appears that confronts mental health professionals with ethical challenges.

Mental health professionals often do not appreciate as important in daily practice and patients desire to marry and / or have children, compared with the case of the parent function. In discussing these desires, often are considered the following topics: "the decision of the patient", "neutrality", " the patient's well-being ", "issues affecting the children of mentally ill parents", "appropriate parenthood" "problems of divorce" and "sexual potency problems". To deal with understanding the norm, mental health professionals have developed strategies as follows: "subordination of child welfare", "de-professionalisation", "giving rational advice" and "resignation".

"Reproductive independence" is in conflict with the topic of "patient's children". Treating taboo problem of reproduction is created gap between the perception of MHP and patients regarding the desire to have children, and limited capacity to deal with them fairly. In order to support both patients with the desire for children (and to be married) and mental health professional's advisory for these patients, they should support the ethical focusing on clinical recommendations in this area.

Key words: marriage, children, ethic, MHP (mental health professionals)

Literature:

-Brockington I, Chandra P, Dubowitz H, Jones D, Moussa S, Nakku J, Quadros Ferrre I: WPA guidance on the protection and promotion of mental health in children of persons with severe mental disorders. *World Psychiatry*. 2011, 10: 93-102.

-Slack K, Webber M: Do we care? Adult mental health professionals' attitudes towards supporting service users' children. *Child Fam Soc Work*. 2008, 13: 72-79.